

Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë (4)

Fajet e të tjerëve për Jugosllavinë

Aktivitetet e Gorbaçovit e kanë thyer Marrëveshjen e Varshavës, e kanë shkatërruar socializmin në Evropën Lindore, i kanë destabilizuar Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë, e kanë thyer marrëveshjen mes fuqive në Evropë, dhe ua kanë lehtësuar armiqve të socialistëve që të vazhdojnë aktivitetet e tyre

Udhëheqësit jugosllavë gjithashtu e kanë fajësuar Gorbaçovin, i cili, sipas tyre, “i ka shitur lehtë idetë e socializmit dhe të komunizmit”. Aktivitetet e tij e kanë thyer Marrëveshjen e Varshavës, e kanë shkatërruar socializmin në Evropën Lindore, e kanë destabilizuar Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë, e kanë thyer marrëveshjen mes fuqive në Evropë, dhe ua kanë lehtësuar armiqve të socialistëve që të vazhdojnë aktivitetet e tyre. Në lidhje me krizën jugosllave, vendet e lëvizjeve të painkuadruara kanë pasur reagime të ndryshme. Si njëri nga themeluesit e lëvizjes së të painkuadruarve, Jugosllavia ka gëzuar një respekt të madh, sidomos nga vendet afrikane. Krizat jugosllave shiheshin si një tronditje e madhe për ta. Një zbrazëti e madhe në kuptimin e krizave jugosllave u vërejt në disa nga vendet, të cilat e kanë përkrahur unitetin e Jugosllavisë me çdo kusht. Disa vende myslimane, si Algjeria, Egjipti, Malajzia, Pakistani, Irani,Tunizia, i kanë shikuar ngjarjet nga prizmi i kërcënimit të popullatës myslimane në Jugosllavi. Ky qëndrim i vendeve myslimane ishte mjaft zhgënjyes, sidomos për politikanët serbë. Pas takimit të

Byrosë së Koordinimeve të të painkuadruarve në Bali, Indonezi, në maj 1992, Borisav Joviq ka shkruar, mes të tjerash, se “shumica e vendeve që kanë marrë ndihmë nga Jugosllavia na e kanë kthyer shpinën dhe nuk janë turpëruar fare”. Përkrahja e këtyre vendeve ishte shumë e rëndësishme për politikën serbe, pasi që këto vende përbënin pothuajse dy të tretat e vendeve anëtare në Kombet e Bashkuara. Që nga maji 1990, konceptet e politikave të jashtme të Hungarisë janë bërë shumë transparente në tri synime: integrimin evropian, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe mbështetje për Hungarinë nga shtetet fqinje. Tensionet jugosllave, megjithatë e kanë komplikuar zbatimin e këtyre synimeve. Në këtë situatë, Qeveria hungareze është dashur që të sinkronizonte pikëpamjet e veta me ato të Evropës Perëndimore dhe të organizatave ndërkombëtare, prandaj ministri i Jashtëm i Hungarisë, Geza Jaszenszky, ka thënë haptas se vendi i tij dëshiron të ketë marrëdhënie “shoqërore” me Kroacinë dhe të jetë “korrekte” me Serbinë. Qëndrimi i Hungarisë që të mos mbështet shkatërrimin e Jugosllavisë është kundërshtuar nga Joviq, i cili në

kujtimet e tij ka shkruar se SHBA-ja në dhjetor të 1990 “ ka kërkuar nga Hungaria që të përdorë të gjitha forcat dhe me ndihmën amerikane të ndihmojë në shkatërrimin e sistemit socialist në Jugosllavi dhe gjithashtu të shkatërrojë bashkimin e Jugosllavisë dhe posaçërisht që të merren masa kundër Serbisë. Duke u bazuar në Joviqin, amerikanët e shihnin Serbinë si shefe e përkrahjes së socializmit në Jugosllavi. ndërsa SHBA-ja e fajësonte Hungarinë, ngase nuk ka ndikuar në politikanët në Jugosllavi. Joviq e ka mbështetur këtë duke e cituar rëndësinë e armëve të bartura nga Kroacia prej Hungarisë më 1990, të cilat kroatët i kanë marrë ilegalisht, që nga pikëpamja e tij, janë përdorur për të formuar ushtrinë e vet. Në fund të janarit të vitit 1991, Televizioni i Beogradit ka transmetuar një xhirim të serviseve inteligjente jugosllave, ku shihen ministri kroat i Mbrojtjes, gjeneral Martin Shpegelj, dhe ministri kroat i Brendshëm, Josip Boljkovac, duke folur për rëndësinë e 20 mijë pushkëve tommy që duhej të vinin nga Hungaria. Historiani hungarez Imre Szilagyi ka shkruar në gazetën e tij se sekretari i Jashtëm i Qeverisë hungareze ka udhëtuar

në Beograd dhe ka shprehur keqardhje për këtë “tension që është krijuar nga problemet e mbarëvajtjes së marrëdhënieve hungaro-jugosllave”, dhe gjithashtu ka shprehur shpresën e tij se debati do të sjellë përsëri miqësinë”. Qeveria hungareze ka insistuar se ishte e përgatitur dhe mund të garantonte se incidentet e tilla nuk do të ndodhnin në të ardhmen, dhe ka deklaruar se lidhjet e reja do të bazohen në besim. Më në fund, qeveria ka lëshuar një formulim “Qeveria hungareze konsideron se Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë është një federatë e bashkuar e disa kombeve. Kufijtë e Jugosllavisë janë të garantuar me dokumente ndërkombëtare, shtetësia e saj është e koordinuar me status quon evropiane, e cila garanton paqe, sigurim dhe bashkëpunim në kontinent, dhe Hungaria nuk është e interesuar në destabilizimin e Jugosllavisë”. Megjithatë, debati ishte shumë larg, qysh kur sekretari i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes së Jugosllavisë , Erno Raffay, menjëherë pas aferës me armë, ka theksuar se armët kanë parandaluar intervenimin e Armatës Popullore Jugosllave në Kroaci. Në përgjigjen e tij, zëvendësministri i Jashtëm jugosllav ka theksuar se ky qëndrim është një shembull klasik i ndërhyrjeve në punët e brendshme të shtetit, ka ftuar Qeverinë hungareze që të konstatojë pozitën e saj në këtë problem, dhe ka insistuar se kjo çështje ende nuk ka përfunduar. Në këtë kontekst, ministri i Jashtëm i Sllovenisë, Dimitrij Rupel, ka paraqitur një përshtkrim të detajizuar të politikës

hungareze, që në atë kohë ishte kontradiktore. Rupel ka arritur në Hungari më 22 maj 1991 dhe ka biseduar me kryeministrin Jozef Antall dhe ministrin e Jashtëm, Jaszensky. Antall pre-razi i ka lavdëruar Slloveninë dhe Kroacinë si vende miqësore dhe i ka mbështetur aspiratat për pavarësi të Sllovenisë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, ai iu ka deklaruar sllovenëve se Milosheviqi po mbante gjysmë milioni hungarezë në Serbi si peng; Hungaria duhet të përmbahet nga marrja e hapave të nxituar. Nga ana tjetër, ai ka theksuar se çështja e njohjes së Sllovenisë dhe Kroacisë si vende të pavarura duhet të koordinohet me Komunitetin Evropian, Këshillin e Evropës dhe NATO-n. Sllovenët kanë thënë se do të ishin shumë të kënaqur nëse Hungaria do të ishte vendi i parë që do të njihte pavarësinë e Sllovenisë. Antall ka thënë se Hungaria nuk do të jetë e para që do të bëjë këtë gjë, duke shtuar se Sllovenia nuk do të fitojë asgjë edhe nëse Hungaria do të bëjë këtë gjë në lidhje me Austrinë. Në atë kohë, askush në Evropën Perëndimore nuk ka menduar seriozisht rreth shpërbërjes së Jugosllavisë. Çuditërisht, ky takim nuk është përmendur fare në shtypin hungarez.

Studimi “Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë” është përpiluar nga një grup punues prej 20 ekspertësh të ndryshëm ndërkombëtarë dhe nga trevat e ish-Jugosllavisë. Udhëheqës të studimit kanë qenë Matjaz Klemençiq dhe Dushan Janjiq.

“Rekuiem për një kampion: historia e Mike Tysonit” (12)

Matematika e Mike Tysonit

Truproja e Lennox Lewisit i doli përpara, por Mike Tysoni nuk e kishte ndërmend të zbrapsej. E qëllloi truprojnë me të majtën dhe e hodhi në dysheme si një kukull plastike. Lennox Lewisi u kundërpërgjigj me një goditje me të djathtën. Dy boksierët së shpejti u kapën për gushe. Grushte pësonin edhe ata që përpiqeshin t'i ndanin

Pas incidentit me veshin e Holyfieldit, Mike Tysoni u detyrua të pauzonte plot një vit e gjysmë dhe të kthehej sërish në ring, njësoj i paparashikueshëm dhe i pamëshirshëm. Pas pesë fitoreve të lehta, atij i erdhi radha të takohej me kampionin e ri, britanikun Lennox Lewis. Më 22 janar të vitit 2002, pritej të konfirmohej lajmi. Një konferencë shtypi ishte paralajmëruar. Para gazetarëve do të dilnin Lewisi dhe Tysoni. I pari në sallën e konferencës në New York u shfaq Tysoni, i veshur me rroba të zeza. Me shpërfillje eci deri në podium dhe u kthye nga dera, prej së cilës pritej të hynte në sallë Lennox Lewisi. Britaniku pas disa gastesh e hapi derën për të hyrë në sallë i përcjellë nga trajnerët dhe truprojat. Me ta parë Lewisin, Mike Tysoni u nis drejt tij rrëmbyeshëm. Njëri nga truprojat e Lewisit i doli përpara dhe provoi ta shtynte. Mirëpo, Tysoni e goditi me një kroshe të majtë dhe e hodhi në dysheme si një kukull plastike. Kur e pa truprojnë e tij të shtrirë në dysheme, Lennox Lewisi vendosi të reagonte. E qëllloi me të djathtën Tysonin në fytyrë dhe ia përgjaku vetullën. As Tysoni nuk

i mbeti borxh. Dy boksierët u kapën për fyti dhe nisën të shtyheshin e të mundeshin para syve të gazetarëve. Askush nuk mund t'i numëronte grushtet e shqelmat. Për një çast, madje, Tysoni e kapi këmbën e Lewisit dhe e kafshoi. Ndonjë grusht e pësonte edhe ndonjëri që përpiqej të ndërhynte për t'i ndarë dy kolosët. Megjithatë, më në fund, turma ndërhyri dhe dy boksierët u ndanë të përgjakur dhe me rroba të shqyera. Pasi u ndanë, Mike Tysoni u shfaq sërish në podium, i ngriti duart lart në shenjë fitoreje dhe pastaj u nis të dilte. Dikush nga turma i tha: “Lëre se e ke fëlliqur”, ndërsa Tysoni u kthye sërish për të parë se kush kishte folur. Ishte i gatshëm që të bënte hatanë. Askush nuk guxoi të bënte cik. As Lewisi. Mirëpo, Lewisi kishte pasur një tjetër plan. Ai e ruante fuqinë e tij për “atje te vendi”. Lewisi e kishte marrë titullin e kampionit të botës në boks në kategorinë e rëndë, pasi e kishte rrahur Evander Holyfieldin, me vesh të shëruar, më 13 nëntor të vitit 1999. Britaniku Lewis kishte pranuar ta mbronte titullin kundër Tysonit, por pas rrahjes në kon-

ferencën e shtypit ai kishte kërcënuar se mund ta anulonte meçin. Ai edhe më herët kishte bërë incidente në konferenca shtypi dhe vetëm disa muaj më parë ishte rrahur me Hasim Rahmanin para gazetarëve, por tani që kishte punë me Mike Tysonin askush nuk po e fajësonte. Verdikti ishte marrë që moti për Tysonin: “Fajtor”. Në të vërtetë, këtë të njëjtin verдикт e kishte dëgjuar edhe tre vjet më parë, në kohën sa ishte i suspenduar. I kishte rrahur një dy veta pas një zënke me veturë dhe ishte dënuar me tre muaj e gjysmë të tjera në burg. Megjithatë, fajtori kujdestar tani ishte shumë i interesuar të rrahej me Lewisin dhe ta kthehnte respektin e humbur. Lewisi kishte vendosur të mos e pranonte Tysonin, por paratë janë të ëmbla dhe britaniku lëshoi pe. Meçi u caktua të zhvillohej në muajin qershor. Atë që e kishin nisur në konferencë shtypi në fund të dimrit, dy boksierët do ta vazhdonin në fund të pranverës në ring. Mike Tysoni këtë herë nuk do t'i çonte duart lart në shenjë triumfi. Ai do të përfundonte i shtrirë në dysheme në rundin e tetë, me të



Lennox Lewisi (majtas) duke e goditur Mike Tysonin në meçin e tyre të vitit 2002

dy vetullat të çara dhe fytyrën të përgjakur. “Nuk ka gjasë që unë ta rrah këtë njeri”, do të thoshte pas duelit Mike Tysoni. Lennox Lewis do të ishte korrekt, po ashtu. “Mendoj se Mike Tysoni është shumë i fortë. Ka duruar të rëna që nuk do t'i duronte askush. Megjithatë, mendoj se nuk ka qenë i gatshëm për këtë meç”. Më i gatshmi për këtë meç kishte qenë menaxheri. Meçi Lewis - Tyson do të konsiderohej meçi që ka sjellë më së shumti fitim nga të gjitha duelet e tjera të botës. Njëqind milionë dollarë janë mbledhur nga ky meç. Menaxheri po qeshej vesh më vesh. Emri i menaxherit nuk ishte Don King. Lewisi nuk e kishte pranuar Kingun për menaxher. “Nuk mund t'i besoj dikujt që flet gjithë ditën e nuk thotë asgjë”, komentonte Lewis për Kingun. Ishte një leksion që Mike Tysoni

do ta kuptonte me vonesë. Disa vjet më herët, Tysoni e kishte akuzuar Kingun se ia kishte vjedhur disa dhjetëra milionë dollarë dhe e kishte shkëputur kontratën. Në të vërtetë, Mike Tysoni nuk kishte asnjëherë shumë i mirë në matematikë. Mirëpo, disi e kishte bërë një hesap të thjeshtë. Meç pas meçi i kishte fituar 300 milionë dollarë. Tani i kishte në xhirlogari 0 dollar. Diçka nuk ishte në rregull. Zero, edhe sipas matematikës së tij, ishte më pak se 300 milionë. Si ia kishte dalë t'i shpenzonte 300 milionë?

(Në numrin e nesërm: Si kaloi dueli me Clifford Etiennin? Si kaloi dueli i ardhshëm në rrugë? Si i kishte shpenzuar 300 milionë dollarët? Kush ishin Danny Williams dhe Kevin McBride?)